



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2021:196231

Datë: 08.07.2022

Numri i dokumentit: 03212925

P.Nr.643/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Rrahman Beqiri, me zyrtare ligjore Atdhetare Bashota Krasniqi, në lëndën penale ndaj të akuzuarit: F.M., për shkak të veprës penale: Lëndim i lehtë trupor, nga neni 185, par.1, pika.1.4, të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (tutje: KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.Nr.1364/2021 (2021:0052108), të datës 02.09.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, më datë 07.07.2022, në prani të Prokurorit të shtetit Arjan Xhema, të pandehurit F.M. dhe mbrojtësit të tij Av. Valdrin Islami, të njëjtën ditë e shpalli publikisht, ndërsa më datë 08.07.2022, e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

F.M., nga i ati N., e ëma F., e vajzërisë A., “data e lindjes”..., në Gjermani, ku edhe tani jeton, me nr. personal:..., i pa martuar, student, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Gjermanisë.

ËSHTË FAJTOR

Sepse,

Më datën 04.08.2021, rreth orës 19:00 h, në Mitrovicë, i pandehuri me dashje i shkakton lëndime trupore personit tjetër dhe atë të dëmtuarit F.H., në atë mënyrë që, derisa i dëmtuari ka qenë duke e drejtuar veturën e tij, me të arritur në afërsi të Stacionit të Autobusëve, në Mitrovicë, përkatësisht në vendin e quajtur “K...”, një veturë e tipit “Audi”, me ngjyrë..., me targa..., ia kishte bllokuar rrugën, nga vetura e tillë kishte dalë i pandehuri, ka shkuar te vetura e të dëmtuarit, ia ka hapur derën dhe ka filluar që ta godasë, e gjithë kjo në prezencën e familjes së të dëmtuarit, me çka të njëjtit i ka shkakuar lëndime trupore dhe atë ndrydhje të indeve të buta me gërvishtje në regjionin e fytyrës (nofulla), të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë, e që si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin,

Me këtë ka kryer veprën penale: Lëndim i lehtë trupor, nga neni 185, par. 1, pika 1.4, të KPRK-së.

Andaj, Gjykata në bazë të nenit 1, 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69 e 185, të KPRK-së, dhe nenit 365, 450, 463 të KPP-së, e:

G J Y K O N

1. Dënim me gjobë në shumën prej 600 € (gjashtë qind euro), të cilën gjobë i pandehuri është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43, të KPRK-së, ashtu që dënimin me gjobë mund t'ia zëvendësoj me dënim me burg, ku një ditë burgim do të llogaritet me 20 (njëzet) euro gjobë.
2. Obligohet i akuzuari, që t'i paguajë shpenzimet e procedurës gjyqësore sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 100 € (njëqind euro), në emër të ekspertizës mjeko – ligjore, shumën prej 20 € (njëzet euro), ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 30 € (tridhjetë euro), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
3. Pala e dëmtuar: F.H., për kërkesën pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko - civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP.II.Nr. 1364/2021 (2021:0052108), të datës 02.09.2021, kundër të akzuarit F.M., për shkak të veprës penale: Lëndim i lehtë trupor, nga neni 185, par.1, pika 1.4, të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor më datë 07.07.2022, në prani të Prokurorit të shtetit Arjan Xhema, të pandehurit F.M. dhe mbrojtësit të tij Av. Valdrin Islami, në të cilën seancë i pandehuri e ka pranuar fajësinë në tërësi sipas aktakuzës, ndërsa në fjalën përfundimtare e luti gjykatën që t'i shqiptoi një dënim sa më të butë ngase është student, i pa punë dhe pa të ardhura.

Prokurori i shtetit Arjan Xhema në lidhje me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se: konsideroj se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë, pranimi është bërë në mënyrë vullnetare, pa presion, pranimi mbështetet në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës, prandaj i ka propozuar Gjykatës që ta pranoj pranimin e fajësisë të deklaruar nga i pandehuri, ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetem në tersi pranë aktakuzës, ku nga pranimi i fajësisë është bërë edhe vërtetimi i gjendjes faktike si në dispozitiv të aktakuzës, duke i propozuar gjykatës që të pandehurin ta shpallë fajtor ta dënoi sipas ligjit duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese me rastin e matjes së dënimit.

Mbrojtësi i të akzuarit, Av. Valdrin Islami në lidhje me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se i propozojë gjykatës që ta bëjë pranimin e fajësisë, pasi që pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në konsultim me mua si mbrojtës dhe pas sqarimeve të mjaftuara nga ana e gjykatës, ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se me rastin e matjes së dënimit e lusim gjykatën që të marr parasysh rrethanat lehtësuese, siç janë pranimi i fajësisë, fakti se i pandehuri për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, i njëjti është student, pa të ardhura personale dhe jeton vetëm nga të ardhurat nga ndihma e shtetit.

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i pandehuri, e në mbështetje të nenit 248, të KPP-së, në këtë drejtim vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të pandehurin. Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit,

mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykate si: Ekspertiza mjekoligjore në emër të të dëmtuarit F.H., e punuar nga Dr. Flamur Blakaj, me datë 12.08.2021; Raporti i oficerit, i datës 04.08.2021; Deklarata e të dëmtuarit F.H., e dhënë në polici me datë 04.08.2021; Raporti i lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm – Emergjenca në Mitrovicë, i datës 04.08.2021, në emër të të dëmtuarit F.H.; Deklarata e të pandehurit F.M., e dhënë në polici me datë 10.08.2021; Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë e tyre dhe pranimit të fajësisë, konsiderojmë se për tej çdo dyshimi është vërtetuar se i pandehuri, ka kryer veprën penale që i vihen në barrë.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në mënyrë vullnetare, se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, duke iu tërhequr vërejtja të pandehurit se pas pranimit të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, por vetëm sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë se të pandehurit dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale: Lëndim i lehtë trupor, nga neni 185, par.1, pika 1.4, të KPRK-së, e për të cilën veprë penale është paraparë dënimi me gjobë ose me burgim deri në 3 (tre) vite.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69, të KPRK-së. Si rrethanë rënduese gjykata e ka vlerësuar mënyrën e veprimit, ashtu që i dëmtuari është sulmuar në praninë e familjes së tij, ndërsa rrethana tjera rënduese nuk ka gjetur.

Ndërsa, si rrethanë lehtësuese gjykata e ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale, faktin se i njëjti ka shpreh keqardhje dhe është penduar për ndodhjen e rasti dhe premtimin se nuk do ta përsërisë më këtë veprë, faktin se i njëjti është student, i papunë dhe tani për tani pa të ardhura personale, krejt kjo duke u bazuar në deklarin e tij, faktin se kjo është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin, ngase nuk ka të dhëna se më herët dyshohet për ndonjë veprë penale tjetër, e po ashtu edhe moshën e re që më lehtë mund të bie nën ndikimin e rrethanave të rastit.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se, shqiptimi i dënimit me gjobë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Po ashtu, gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38, të KPRK-së, që ti parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Po ashtu, ky dënim do të shërbejë si masë preventive që në të ardhmen i pandehuri të përmbahet nga çfarëdo raporti me njerëz.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450, par. 2 pika 2.1 dhe 2.6 dhe nenit 453, par.1, të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit gjyqësor. Ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 39, par.3, të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, Gjykata ka vendosur si në dispozitiv, duke e udhëzuar palën e dëmtuar për kontest civil, ngase të dhënat në këtë procedurë nuk kanë qenë të mjaftueshme për të vendosur në lidhje me këtë kërkesë.

Andaj, Gjykata, duke u bazuar me neni 365, 450, 453 e 463 të KPP-së, nga arsyet e lartcekura ka vendosur si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm
P.Nr.643/2021, datë 08.07.2022
2021:196231, 08.07.2022

Zyrtare Ligjore:
Atdhetare Bashota Krasniqi

Gjyqtari

Rrahman BEQIRI

Këshillë juridike: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet në këtë Gjykatë, e për Gjykatën e Apelit.